LIGJ
Nr.7667, datë 28.1.1993

PËR REGJISTRIN ZYRTAR DHE FORMALITETET QË DUHEN RESPEKTUAR NGA SHOQËRITË TREGTARE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I

REGJISTRI TREGTAR
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Mbajtja e regjistrit nga gjykata

Regjistri tregtar mbahet nga Gjykata e Rrethit të Tiranës për gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 2
Kompetencat e gjyqtarit

Gjyqtari ka të gjitha kompetencat për kryerjen e akteve të gjykatës që kanë të bëjnë me regjistrin tregtar, me përjashtim të atyre që ky ligj ose dispozita të tjera ligjore ia japin sektorit të gjyqit.

Neni 3
Përjashtimi i një gjyqtari

Një gjyqtar përjashtohet nga ushtrimi i detyrës së tij:

a) nëse ai vetë është njëra nga palët në një çështje tregtare, ose është në marrëdhënie si bashkëpronar apo bashkëdebitor me njërën prej palëve;

b) në çështjet tregtare të bashkëshortes së tij, madje edhe kur martesa është zgjidhur;

c) në çështjet tregtare të një personi, me të cilin ai është farefis ose krushqi e afërt;

ç) në çështjet tregtare ku ai është emëruar si përfaqësues i njërës prej palëve, ose ku ai ka të drejtën ligjore të paraqitet si përfaqësues i një pale të tillë.

Neni 4
Akti i një gjyqtari të përjashtuar ose jokompetent

Aktet e gjykatës janë të pavlefshme, kur janë kryer nga një gjyqtar që ka qenë përjashtuar nga ushtrimi i detyrës së tij si gjyqtar sipas nenit 3 të këtij ligji. Pasojat që rrjedhin nga pavlefshmëria e tyre, zgjidhen sipas rregullave për pavlefshmërinë e veprimit juridik.

Neni 5
Kompetencat e sekretarit të gjyqit

Sekretari i gjyqit është kompetent për:

a) lëshimin e kopjeve të regjistrimit dhe të dokumenteve të depozituara në aneksin e regjistrit.

Nëse kërkohet një kopje ekstrakti (teksti të pjesshëm), është gjyqtari ai që vendos për vëllimin e tekstit të pjesshëm;

b) çertifikatën e konformitetit dhe dëshmitë e parashikuara në nenin 14, paragrafi 2 i ligjit nr.7632, datë 4.11.1992 "Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të kodit tregtar";

c) regjistrimin e çeljes së një procedure shlyerjeje dëmi ose likuidimi në rrugë gjyqësore.

Kur kërkohet të ndryshohet një dokument i lëshuar nga sekretari i gjyqit dhe ky nuk e bën një gjë të tillë, është kompetencë e gjyqtarit të marrë vendim. Ankim mund të bëhet vetëm kundër vendimit të gjytarit.

Neni 6
Konsultimi i regjistrit

Regjistri dhe dokumentet e depozituara në aneksin e regjistrit duhet të paraqiten për t'u konsultuar nga publiku i gjerë gjatë orarit zyrtar në zyrat e gjykatës.

Neni 7
Gazeta të orientuara për publikimin e njoftimeve ligjore

Gazeta ose gazetat në të cilat lejohet të publikohen regjistrimet gjatë vitit të ardhshëm, caktohen nga Këshilli i Ministrave, brenda datës 6 dhjetor të çdo viti.

Neni 8
Degët dhe përfaqësitë e tregtarëve dhe të shoqërive tregtare të huaja

Për degët dhe përfaqësitë e tregtarëve e të shoqërive tregtare të huaja, faktet e dokumentet regjistrohen në regjistrin tregtar dhe depozitohen në aneksin e tij, siç veprohet për tregtarët dhe shoqëritë tregtare shqiptare.

Neni 9
Përjashtimi nga regjistrimi për tregtarët e vegjël

Përjashtohen nga detyrimi për t'u regjistruar në regjistrin tregtar tregtarët që janë persona fizikë, për të cilët vëllimi i përgjithshëm i qarkullimit gjatë dy viteve kalendarike të një pasnjëshëm nuk ka tejkaluar tavanin e fiksuar me vendim të Këshillit të Ministrave ose ata, për të cilët tejkalimi i këtij tavani gjate vitit në vazhdim dhe atij pasardhës nuk është i mundshëm, po qe se sipërmarja e tyre sapo është krijuar.

MBAJTJA E REGJISTRIT TREGTAR

Neni 10
Forma e jashtme

Regjistrat mbahen në formë skedarësh. Ata duhet të mbahen në përputhje me modelet e bashkëngjitura në aneksin 1.

Neni 11
Dosjet e regjistrit

Dokumentet e regjistruara në aneksin e regjistrit mbahen në një dosje të veçantë për çdo skedë të regjistrit (sipas nenit 13 të këtij ligji) ose për çdo shoqëri që formohet (sipas neneve 78 dhe 85 të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare").

Nëse aktet origjinale që duhet të depozitohen në regjistër i kthehen të interesuarve, në dosje ruhet një kopje e legalizuar. Në qoftë se akti përmbahet në dosje të ndryshme të gjykatës, në dosjen e regjistrit futet një kopje e legalizuar. Pjesët e aktit që janë të parëndësishme për t'u mbajtur në

regjistrin tregtar, mund të suprimohen nga kopja. Në rast dyshimi, për vëllimin e tekstit të kopjes vendos gjyqtari ose, në mungesë të tij sekretari i gjyqit.

Neni 12
Rregullshmëria

Regjistrimet duhet të bëhen në mënyrë të qartë dhe si rregull pa shkurtime. Në rregjistër asgjë nuk duhet të fshihet ose të bëhet e palexueshme.

Neni 13
Skeda e regjistrit

Çdo tregtar individual dhe çdo shoqëri tregtare duhet të regjistrohen në regjistër me një numër të ri regjistrimi. Një a më shumë skeda mbahen në regjistër për çdo numër regjistrimi, të titulluara së bashku "skeda e regjistrit".

Kur në emërtimin tregtar ka ndryshim, ky regjistrohet në të njëjtën skedë të regjistrit. Në qoftë se është e nevojshme të qartësohet më mirë, emërtimi i ri tregtar regjistrohet bashkë me të gjitha regjistrimet e vjetra që janë ende të vlefshme, me një numër të ri regjistrimi dhe në një skedë të re të regjistrit. Në këtë rast në çdo skedë jepet referenca me skedën tjetër.

Në rast shndërrrimi, shoqëria e shndërruar regjistrohet gjithmonë në një skedë të re të regjistrit.

Neni 14
Numërimi i regjistrimeve

Çdo regjistrim bëhet në një numër të ri rendor dhe të ndarë nga regjistrimi pasardhës me një vijë horizontale që kalon në të gjitha kolonat e regjistrit.

Në rastin e disa regjistrimeve të njëkohshme, ato bëhen në një numër rendor të vetëm.

Neni 15
Data e regjistrimit

Për çdo regjistrim shënohet data e regjistrimit. Data e regjistrimit dhe vendi i saj në regjistër tregohen në vendimin e gjyqtarit që urdhëron hapjen e dosjes së regjistrimit.

Neni 16
Ndryshimi i regjistrimeve

Ndryshimet e përmbajtjes së një rregjistrimi dhe prishjet me nënvizim duhet të regjistrohen në një numër rendor të ri. Një regjistrim që ka humbur rëndësinë e tij, për shkak të një regjistrimi të ri, nënvizohet sipas vendimit të gjyqtarit. Njëkohësisht me regjistrimin nënvizohet edhe shënimi që lidhet me prishjen me nënvizim.

Neni 17
Korrigjimet e gabimeve të shtypit

Gabimet e shtypit dhe gabimet e dukshme të këtij lloji, të bëra gjatë një regjistrimi, korrigjohen sipas vendimit të gjyqtarit në anë të këtij regjistrimi, në kolonën 5 me titullin "Shënime". Shënimi që përmban korrigjimin firmoset nga sekretari i gjyqit, duke treguar edhe datën e korrigjimit.

Korigjimi duhet t'i komunikohet të interesuarve. Publikimi mund të mos bëhet, në qoftë se korrigjimi i përket një diçkaje jothelbësore.

Një nënvizim i bërë gabimisht mënjanohet, duke prishur nënvizimin me kryqe të vogla.

Neni 18
Regjistrimi mbi bazën e një vendimi gjyqësor

Në qoftë se regjistrimi është bërë mbi bazën e një vendimi të një procedure gjyqësore, me fuqi ligjore ose zbatuese, kjo duhet të tregohet gjatë regjistrimit në regjistër. Në të njëjtë kolonë të regjistrit regjistrohet edhe data e marjes së vendimit.

Neni 19
Prishja me nënvizim e regjistrimeve të paligjshme

Kur një regjistrim është bërë në regjistrin tregtar ndërkohë që ka qenë i paligjshëm për mungesë të një kushti thelbësor, ai duhet të prishet me nënvizim nga regjistri me iniciativën dhe kompetencën e gjykatës. Kjo e fundit duhet t'u komunikojë të interesuarve që ka ndërmend ta prishe me nënvizim dhe njëkohësisht t'u caktojë një afat për ankim.

Për procedurat e neneve të mëposhtme të këtij kreu zbatohen dispozitat e paragrafëve 4 e 5 të nenit 44 të këtij ligji.

Neni 20
Procedura në rast prishjeje me nënvizim ose regjistrimi, të bëra nga gjykata me iniciativën dhe kompetencën e saj

Nëse një regjistrim duhet të prishet me nënvizim nga gjykata në zbatim të nenit 19 të këtij ligji, prishja bëhet duke regjistruar shënimin "Prishur me iniciativë dhe kompetencë".

Kur një regjistrim duhet bërë me iniciativë dhe kompetencë në raste të tjera, ai duhet të pasqyrojë bazën ligjore dhe shënimin "Regjistruar me iniciativë dhe kompetencë", me përjashtim të rastit për fillimin e procedurës së shlyerjes së dëmit ose të likuidimit në rrugë gjyqësore.

Neni 21
Krijimi i një skede të re regjistrimi

Kur një skedë e regjistrit nuk është e qartë, regjistrimet që mbeten të vlefshme mund të kopjohen në një skedë të re të regjistrimit me numër të ri regjistrimi, pasi të jetë marrë pëlqimi i tregtarit ose i shoqërisë së regjistruar. Në këtë rast, në çdo skedë të regjistrit jepet referenca me skedën tjetër.

Neni 22
Skeda të regjistrit të mbetura pa objekt

Faqeve të skedës së regjistrit, kur të gjitha regjistrimet që përmbahen në to kanë mbetur pa objekt, u vihet kryq.

PROCEDURA E REGJISTRIMIT DHE E PUBLIKIMIT

Neni 23
Marrja mendim nga dhoma e tregtisë

Për të mënjanuar regjistrimet e paligjshme, gjyqtari duhet të konsultohet dhe të marrë vërejtjet e dhomës së tregtisë si në rastin e regjistrimit të emrave të rinj tregtarë ose të ndryshimit të emrave tregtarë, ashtu edhe kur ka dyshime të ndryshme, me përjashtim të rasteve kur kjo marrje mendimi është e papërshtatshme për arsye të veçanta.

Neni 24
Vendimi i gjyqtarit

Gjyqtari vendos për kërkesat e regjistrimit dhe kërkesat e tjera, brenda 30 ditëve nga data e

depozitimit të kërkesës në gjykatë. Ai gjithashtu vendos edhe për publikimet e nevojshme.

Vendimi për regjistrimin jepet nga gjyqtari, edhe në rastin kur një gjykatë tjetër ka marrë vendim për këtë.

Neni 25

Njoftimi i shkaqeve të mospranimit

Kur një regjistrim nuk është pranuar, shkaqet duhet të njoftohen. nëse një kërkesë për regjistrim në regjistrin tregtar është jo e plotë ose nëse ka ndonjë pengesë të çfarëdoshme për regjistrim, caktohet një afat për ta kaluar këtë pengesë.

Neni 26

Përmbajtja e vendimit të regjistrimit

Në vendimin e regjistrimit caktohet teksti i regjistrimit. Teksti i publikimit, në qoftë se ndryshon nga teksti i regjistrimit, caktohet në mëyrë të veçantë.

Neni 27

Ekzekutimi i vendimit të regjistrimit

Sekretari i gjyqit ka për detyrë të zbatojë vendimin e regjistrimit, firmosjen e aktit të regjistrimit dhe realizimin e publikimit.

Neni 28

Kopjet e regjistrit tregtar

Kopjet bëhen duke kopjuar skedën e regjistrit ose dokumente të depozituara në aneksin e regjistrit tregtar. Kopjet e thjeshta pajisen me shënimin "Kopje e bërë në datën...", i cili nuk firmoset.

Legalizimi i njësimit të një kopjeje me origjinalin bëhet me një shënim të vënë poshtë regjistrimit të fundit të kopjes me tekstin e mëposhtëm: "Vërtetohet njësimi i kopjes me regjistrimet origjinale në regjistrin tregtar". Shënimi i legalizimit duhet të tregojë vendin dhe datën e bërjes së tij, të firmoset nga sekretari i gjyqit dhe të ketë vulën e gjykatës. Kur ka më shumë skeda, ato lidhen në formën e duhur për aktet autentike.

Kur kërkohen kopje të legalizuara të dokumenteve të depozituara në aneksin e regjistrit, shënimi i legalizimit duhet të tregojë nëse dokumenti kryesor është origjinal, kopje e thjeshtë apo kopje e legalizuar.

Neni 29

Vërtetime dhe dëshmi

Vërtetimet dhe dëshmitë firmosen nga sekretari i gjyqit, duke treguar vendin e datën, si dhe kanë vulën e gjykatës.

Neni 30

Publikimi i regjistrimit

Publikimi i regjistrimit duhet të bëhet pa vonesë. Në tekstet e publikuara tregohet gjykata dhe data e regjistrimit. Këto tekste nuk firmosen.

Neni 31

Njoftimi i shkakut të prishjes me nënvizim

Në rast prishjeje me nënvizim të regjistrimit të një tregtari për arsye se personi që kryen veprimtarinë nuk konsiderohet tregtar shkaku i prishjes me nënvizim mund të theksohet në tekstin e publikuar, me kërkesën e të interesuarit.

Neni 32
Njoftimi i kërkuesit

Çdo regjistrim i njoftohet atij që e ka kërkuar dhe dhomës së tregtisë. I interesuari mund të heqë dorë nga e drejta për t'u njoftuar.

REGJISTRIMET NË SKEDËN E REGJISTRIT

Neni 33
Regjistrimet në kolona të ndryshme

Regjistrimet në kolona të ndryshme të skedës së regjistrit bëhen si më poshtë:

- Në kolonën 1: numri rendor i regjistrimit përkatës

- Në kolonën 2:

në (a) emërtimi tregtar;

në (b) vendi i sipërmarrjes tregtare ose i selisë së shoqërisë; për degët dhe përfaqësitë e tregtarëve ose shoqërive tregtare të huaja, vendi i sipërmarrjes së tyre kryesore në Shqipëri, të pasuar me shënimin "degë e...", ose "përfaqësi e...", me emërtimin tregtar të tregtarit ose të shoqërisë dhe me vendin e sipërmarrjes ose selinë kryesore në shtetin e huaj;

në (c) në rastin e shoqërive tregtare: objekti i shoqërisë dhe ndryshimet përkatëse;

në (ç) në rastin e shoqërive tregtare: vlera e kapitalit themeltar.

- Në kolonën 3: tregtari si person fizik që është titullar i sipërmarrjes, administratorët për shoqëritë kolektive, shoqëritë komandite dhe shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, anëtarët e drejtorisë për shoqëritë anonime dhe likuiduesit, duke dhënë në çdo rast emrin, mbiemrin, vendlindjen dhe datëlindjen.

- Në kolonën 4: regjistrime të tjera si:

a) data e firmosjes së statutit të shoqërisë;

b) dispozitat e statutit që lidhen me kohëzgjatjen e shoqërisë, kur ajo është e përcaktuar;

c) kompetencat e përfaqësimit të administratorëve, anëtarëve të drejtorisë ose likuiduesve;

ç) çdo ndryshim në personalitetin e administratorëve, anëtarëve të drejtorisë ose likuiduesve, si dhe çdo ndryshim në kompetencat e përfaqësimit të njërit prej këtyre personavve;

d) emrat, mbiemrat dhe datëlindjet e ortakëve që nuk janë administratorë të një shoqërie kolektive, si dhe ato të ortakëve të pakufizuar që nuk janë administratorë të një shoqërie komandite;

dh) emrat, mbiemrat, datëlindjet dhe vlera e kontributeve në kapital të ortakëve "të kufizuar";

e) çdo ndryshim në personalitetin e ortakëve të një shoqërie kolektive ose shoqërie komandite, si dhe çdo ndryshim i vlerës së kontributeve në kapital të ortakëve "të kufizuar".

ë) çdo ndryshim i statutit, veçanërisht ndryshimet e kapitalit themeltar. Përsa i përket regjistrimit, mjafton të tregohet në mëyrë të përgjithshme objekti i ndryshimit; në këtë rast duhet të jepet referencë në kolonën 5 me titullin "Shënime" të dokumentit të depozituar në aneksin e regjistrit dhe të faqes së skedës ku ndodhen dokumentet;

f) në rast kalimi të sipërmarrjes tregtare me akt ndërmjet të gjallëve: një deklaratë që përjashton kalimin e detyrimeve dhe të drejtave në bazë të nenit 12 të ligjit nr.7632, datë 4.11.1992 "Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të kodit tregtar";

g) ndryshimet e pronësisë së tregtarit që është titullar i një veprimtarie tregtare në bazë të nenit 20 të ligjit nr.7632, datë 4.11.1992 "Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të kodit tregtar";

gj) fillimi i shoqërisë, mbyllja e saj ose hapja e një procedure për shlyerjen e dëmit ose likuidimin në rrugë gjyqësore;

h) vendimi i parashikuar në nenin 72 të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", në rast humbjeje të më shumë se gjysmës së kapitalit themeltar;

i) prishja dhe pavlefshmëria e shoqërisë; bashkimi ose ndarja; prishja me nënvizim e tregtarit ose e shoqërisë;

- Në kolonën 5:

në (a) data e regjistrimit dhe firma e sekretarit të gjyqit;

në (b) regjistrimi i referencave për regjistrimet e mëvonshme, tregimi i numrit të regjistrimit të

një personi juridik, i cili është ortak i një shoqërie kolektive ose ortak i pakufizuar i një shoqërie komandite, si dhe shënime të tjera.

Neni 34
Vendimi i deklaruar si i pavlefshëm

Vendimi i formës së prerë të një gjykate, nëpërmjet të cilit një vendim i Asamblesë të një shoqërie anonime ose ortakëve të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar është deklaruar si i pavlefshëm, duhet të regjistrohet me një shënim që tregon vendimin e pavlefshëm, në kolonën e skedës së regjistrit ku ka qenë regjistruar ai vendim.

Neni 35
Bashkimi

Në rastet e bashkimit, regjistrimet që u përkasin shoqërive të përthithura, prishen me nënvizime gjatë regjistrimit të bashkimit. Për shoqërinë përthithëse jepet referenca në kolonën 5 me titullin "Shënime" në skedën e regjistrit të shoqërive të përthithura dhe anasjelltas.

Në rastet e ndarjes, regjistrimet që i përkasin shoqërisë së ndarë, prishen me nënvizime gjatë regjistrimit të ndarjes. Për shoqëritë që përfitojnë kontributet, jepet referenca në kolonën 5 me titullinn "Shënime" në skedën e regjistrit të shoqërisë së ndarë dhe anasjelltas.

PROCEDURA DHE DETYRIMI

Neni 36
Pezullimi i procedurës për një vendim që i përket regjistrit

Gjykata mund ta pezullojë vazhdimin e procedurës për zbatimin e një vendimi për regjistrin, kur kjo varet nga vlerësimi i një situate ligjore që është objekt i një procedure gjyqësore. Për sa kohë që kjo procedurë nuk ka filluar, gjykata mund t'i caktojë një afat njërit prej të interesuarve për të nisur instancën gjyqësore.

Neni 37
Vendim për përmbushjen e një detyrimi ligjor

Për rastet e parashikuara në nenin 25 të ligjit nr.7632, datë 4.11.1992 "Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të kodit tregtar", gjykata urdhëron me vendim të interesuarin të përmbushë detyrimin për të bërë regjistrim në regjistrin tregtar, ose për të depozituar në aneksin e regjistrit firmën ose një dokumentacion. Ajo i cakton një afat për përmbushjen e këtij detyrimi ose për ankimin ndaj vendimit të sipërpërmendur të kësaj gjykate. Njëkohësisht ajo paralajmëron të interesuarin për shumën e gjobës që ai duhet të paguajë në rast moszbatimi të pajustifikuar të këtij detyrimi.

Neni 38
Caktimi i gjobës

Nëse i interesuari nuk ka përmbushur detyrimin ligjor dhe nuk është ankuar për çështjen brenda afatit, gjykata cakton shumën e gjobës që duhet të paguajë i interesuari, sipas paralajmërimit dhe njëkohësisht përsërit urdhrin e mëparshëm, duke paralajmëruar të interesuarin për shumën e gjobës së re që duhet paguar, në rast vazhdimi të moszbatimit të pajustifikuar të vendimit.

Gjykata vazhdon të veprojë në këtë mënyrë, derisa të përmbushet detyrimi ligjor ose të bëhet ankim për çështjen.

Neni 39
Ankimi

Në rast se është bërë ankim brenda afatit dhe ai konsiderohet i bazuar, Gjykata e Apelit fton të

interesuarin në një seancë dëgjimi.

Gjykata e Apelit, mbi bazën e fakteve të njohura, mund të marrë vendimin e saj në datën e caktuar të seancës, qoftë edhe në mungesë të të interesuarit.

Neni 40
Vendimi për ankimin

Kur ankimi gjykohet i bazuar, vendimi i dhënë nga gjykata bie nga fuqia. Në rast të kundërt, Gjykata e Apelit nuk e pranon ankimin. Në qoftë se ka rrethana lehtësuese, Gjykata e Apelit mund të mos caktojë gjobë ose të caktojë një gjobë më të vogël se ajo e njoftuar në paralajmërim.

Në rast mospranimi të ankimit, Gjykata e Apelit urdhëron të interesuarin me një vendim të ri në bazë të nenit 37 të këtij ligji. Afati i caktuar në këtë vendim të ri fillon në datën kur mospranimi i ankimit ka hyrë në fuqi.

Neni 41
Ankimi kundër vendimit të ri

Në rastin e nenit 38 të këtij ligji, në qoftë se është bërë ankim kundër vendimit të ri të gjykatës dhe ky është gjykuar i përligjur, Gjykata e Apelit ka mundësi, kur rrethanat e lejojnë, të heqë gjobën e caktuar më parë ose të caktojë në vend të saj një gjobë më të vogël.

Neni 42
Ngarkimi i shpenzimeve

Krahas caktimit të gjobës, i interesuari detyrohet nga gjykata të përballojë shpenzimet e gjyqit.

Neni 43
Ankim në Gjykatën e Kasacionit

Vendimi që cakton gjobën ose që hedh poshtë ankimin, mund të bëhet subjekt i një ankimi tjetër. Në këtë rast palët e interesuara i drejtohen Gjykatës së Kasacionit sipas rregullave përkatëse.

Neni 44
Prishja me nënvizim e një tregtari person fizik

Regjistrimi i një tregtari person fizik duhet të prishet me nënvizim, kur ai pushon së ushtruari veprimtarinë e tij tregtare për një kohë të gjatë.

Gjykata i komunikon personit të regjistruar si titullar i sipërmarrjes së regjistruar ose personit që ka marrë të drejtat e tij, qëllimin për prishje me nënvizim dhe i cakton atij një afat për të bërë ankim. Afati nuk duhet të jetë më i vogël se tre muaj.

Në qoftë se personat e përmendur në paragrafin e mësipërm ose adresat e tyre nuk njihen, komunikimi dhe caktimi i afatit bëhen duke i publikuar në njërën prej gazetave të autorizuara për publikimin e njoftimeve ligjore.

Në rast ankimi vendos gjykata. Palët për këtë vendim mund t'i drejtohen Gjykatës së Apelit.

Prishja me nënvizim mund të regjistrohet vetëm nëse nuk është bërë asnjë ankim në afatin e caktuar ose, nëse vendimi që hedh poshtë ankimin, ka hyrë në fuqi.

KREU II
FORMALITETE TË VEÇANTA PËR T'U RESPEKTUAR NGA SHOQËRITË TREGTARE
THEMELIMI I NJË SHOQËRIE ANONIME ME OFERTË PUBLIKE

Neni 45

Njoftim gjatë themelimit të një shoqërie anonime me oferta publike

Njoftimi i parashikuar në nenin 78, paragrafi 2, të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", publikohet në një gazetë të autorizuar për publikimin e njoftimeve ligjore përpara fillimit të operacioneve të nënshkrimit dhe përpara çdo veprimi tjetër publikimi.

Ky njoftim tregon emërtimin e shoqërisë, shumën e kapitalit themeltar që duhet nënshkruar, adresën e parashikuar të selisë së shoqërisë, një përmbledhje të objektit të shoqërisë, kohëzgjatjen e shoqërisë, kur ajo është e përcaktuar, datën dhe vendin e depozitimit të projektstatutit si dhe:

a) Numrin e aksioneve për kontributin në para që janë për t'u nënshkruar dhe shumën që kërkohet menjëherë.

b) Vlerën nominale të aksioneve që janë për t'u emetuar.

c) Përshkrimin e përmbledhur të kontributeve në natyrë, vlerësimin global të tyre dhe mënyrën e shlyerjes.

ç) Avantazhet e veçanta të formuluara në projektstatut të cilat i përfiton çdo person.

d) Kushtet e pranimit dhe të ushtrimit të së drejtës së votës në mbledhjet e Asamblesë së aksionerëve.

dh) Në qoftë se është e nevojshme, klauzolat përksatëse për miratimin e personave që i shesin aksionet e tyre.

e) Dispozitat përkatëse për shpërndarjen e fitimeve, krijimin e rezervave dhe shpërndarjen e shumës që mbetet pas likuidimit të shoqërisë.

ë) Emrin dhe adresën e noterit, ose emërtimin dhe selinë e bankës ku do të depozitohen fondet e ardhura nga nënshkrimi.

f) Afatin e caktuar për nënshkrimin, duke lënë të hapur mundësinë e mbylljes së parakohshme të nënshkrimit, në qoftë se nënshkrimi është bërë i plotë përpara përfundimit të afatit të mësipërm.

g) Mënyrën e thirrjes së Asamblesë themeluese dhe vendin e mbledhjes.

Njoftimi firmoset nga themeluesit e shoqërisë të cilët tregojnë emrat, mbiemrat, adresat e banimit dhe shtëpinë, ose emërtimin, formën, selinë dhe shumën e kapitalit themelor të shoqërisë së tyre.

Neni 46

Prospektet dhe qarkoret

Prospektet për qëllim reklame dhe qarkoret që informojnë publikimin për emetimin e aksioneve, përmbajne të njëjtat njoftime si ato të parashikuara në nenin e mësipërm, si dhe shënimin që ai njoftim është publikuar në një gazetë të autorizuar për publikimin e njoftimeve ligjore, duke dhënë referencën mbi emrin e gazetës dhe numrin ku është publikuar njoftimi. Gjithashtu, ato duhet të paraqesin në mënyrë të përmbledhur projektet e themeluesve përsa i përket përdorimit të fondeve që vijnë nga shlyerja e aksioneve të nënshkruara.

Neni 47

Buletini i nënshkrimeve

Buletini i nënshkrimeve, i parashikuar në nenin 81 të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" përmban datën dhe firmën e nënshkruesit ose personit të autorizuar prej tij me prokurë, i cili shkruan me shkronja numrin e aksioneve që ai nënshkruan. Atij i jepet një kopje e buletinit.

Buletini i nënshkrimeve shpreh emërtimin e shoqërisë, shumën e kapitalit themeltar për t'u nënshkruar, adresën e parashikuar të selisë së shoqërisë, një përmbledhje të objektit të shoqërisë, datën dhe vendin e depozitimit të projektstatutit, si dhe:

a) Në qoftë se është e nevojshme, pjesën e kapitalit në para që duhet nënshkruar dhe pjesën e kapitalit që vjen nga kontributet në natyrë.

b) Mënyrën e emetimit të aksioneve, të nënshkruara për kontributin në para.

c) Emrin dhe adresën e noterit ose emërtimin dhe selinë e bankës, ku do të depozitohen fondet e ardhura nga nënshkrimi.

ç) Emrin, mbiemrin dhe adresën e banimit të nënshkruesit, si dhe numrin e letrave me vlerë të nënshkruara prej tij.

d) Shënimin për dhënien e nënshkruesit të një kopjeje të buletinit të nënshkrimeve.

dh) Datën e publikimit të njoftimit, të parashikuar në nenin 45 të këtij ligji, në një gazetë të autorizuar për publikimin e njoftimeve ligjore.

MBLEDHJET E ASAMBLESË SË AKSIONAREVE

Neni 48
Drejtimi i mbledhjes së Asamblesë

Mbledhjet e Asamblesë së aksionarëve drejtohen nga kryetari i këshillit mbikëqyrës ose, në mungesë të tij, nga personi i parashikuar në statut; përndryshe vetë Asambleja, zgjedh një drejtues të mbledhjes së saj. Në rast thirrjeje të Asamblesë nga ekspertët kontabël të autorizuar, nga një mandatmbajtës i autorizuar nga gjykata ose nga likuiduesit, mbledhja e Asamblesë drejtohet nga personi ose njëri prej personave që e kanë thirrur këtë mbledhje. Drejtuesi i Asamblesë cakton një sekretar që, me përjashtim të rasteve kur në statut ka dispozita të kundërta, mund të mos jetë aksionar.

Neni 49
Evidenca e pjesëmarrjes

Evidenca e pjesëmarrjes së aksionerëve në mbledhjen e Asamblesë, e parashikuar në nenin 142 të ligjit "Për shoqëritë tregtare", përmban shënimet e mëposhtme:

a) Emrin, mbiemrin dhe adresën e banimit të çdo aksionari të pranishëm, numrin e aksioneve që ai zotëron, si dhe numrin e votave që i përgjigjet këtyre aksioneve.

b) Emrin, mbiemrin dhe adresën e banimit të çdo aksionari të përfaqësuar, numrin e aksioneve që ai zotëron, dhe numrin e votave që u përgjigjen këtyre aksioneve.

c) Emrin, mbiemrin dhe adresën e banimit të çdo mandatmbajtësi, numrin e aksioneve të personave që i kanë dhënë atij këtë mandat, si dhe numrin e votave që u përgjigjet këtyre aksioneve.

ç) Emrin, mbiemrin dhe adresën e banimit të çdo aksionari që i ka çuar me korrespondencë shoqërisë një formular vote, si dhe numrin e aksioneve që ai zotëron dhe numrin e votave që u përgjigjen këtyre aksioneve.

Evidenca e pjesëmarrjes e firmosur sipas rregullave nga aksionarët e pranishëm dhe mandatmbajtësit, legalizohet në mëyrë të saktë nga drejtuesi dhe sekretari i Asamblesë.

Neni 50
Procesverbali

Procesverbali i çështjeve të shqyrtuara në mbledhjen e Asamblesë tregon datën dhe vendin e mbledhjes, mënyrën e thirrjes, rendin e ditës, emrat e drejtuesit e të sekretarit të Asamblesë, numrin e aksioneve me të cilat është votuar dhe quorumin e arritur, dokumentet dhe raportet e shqyrtuara në mbledhjen e Asamblesë, një përmbledhje e debateve, tekstin e vendimeve të kaluara në votim dhe rezultatin e votimit. Procesverbali firmoset nga drejtuesi dhe sekretari i Asamblesë.

Neni 51
Ruajtja e evidencave të pjesëmarrjes dhe e procesverbaleve

Evidencat e pjesëmarrjes dhe procesverbalet ruhen përgjithmonë në selinë e shoqërisë.

EMETIMI I AKSIONEVE TË REJA

Neni 52
Shpallja e emetimit

Aksionarët informohen për emetimin e aksioneve të reja dhe për mënyrën e emetimit nëpërmjet një shpalljeje që tregon emetimin e shoqërisë, shumën e kapitalit themeltar, adresën e selisë së shoqërisë, numrin e regjistrimit në regjistrin tregtar, si dhe:

a) Shumën e zmadhimit të kapitalit;

b) Datat e hapjes dhe të mbylljes së nënshkrimeve;

c) Qenien në dobi të aksionarëve të së drejtës së përparësisë në nënshkrimin e aksioneve të reja, si dhe kushtet e ushtrimit të kësaj të drejte.

ç) Vlerën nominale të aksioneve për kontributin në para që duhet nënshkruar dhe, në qoftë së është e nevojshme, shumën e primit të emetimit.

d) Shumën që kërkohet të paguhet menjëherë nga aksionet e nënshkruara.

dh) Emrin e personit fizik ose emërtimin e shoqërisë, dresën e banimit ose të selisë së depozituesit.

e) Në qoftë se është e nevojshme, përshkrimin e permbledhur, vlerësimin dhe mënyrën e shlyerjes së kontributeve në natyrë që përmbahen në zmadhimin e kapitalit, duke treguar karakterin e përkohshëm të këtij vlerësimi dhe të kësaj mënyre shlyerjeje.

ë) Shënimin që, në qoftë se aksionet e përshkruara përfaqësojnë më shumë se tre për qind të zmadhimit të kapitalit, nënshkrimi do të jetë i hapur për publikun e gjerë ose do të quhet i mbyllur me shumën e nënshkrimeve të kryera.

Nëse shoqëria është me ofertë publike, shpallja futet në një njoftim të botuar në një gazetë të autorizuar për publikimin e njoftimeve ligjore, të paktën gjashtë ditë përpara hapjes së ditës së nënshkrimit.

Në rast të kundërt njoftimet e parashikuara në paragrafin e parë, brenda të njëjtit afat, u bëhen të njohura aksionarëve me letër rekomande me përgjigje për marrjen e lajmërimit.

Neni 53

Përjashtimi, në rast se hiqet dorë nga e drejta e përparësisë

Në qoftë se Asambleja ka vendosur për të hequr dorë nga e drejta e përparësisë së aksioneve në nënshkrim, dispozitat e nenit të mësipërm nuk zbatohen.

Neni 54

Përmbajtja e njoftimit për publikim

Njoftimi i përmendur në nenin 52, paragrafi 2, i këtij ligji përmban këto të dhëna:

a) Përmbledhjen e objektit të shoqërisë.

b) Datën e përfundimit normal të shoqërisë, kur kohëzgjatja e saj është përcaktuar.

c) Kategoritë e aksioneve të emetuara dhe karakteristikat e tyre.

ç) Avantazhet e veçanta të formuluara në statut në dobi të çdo personi.

d) Kushtet e pranimit dhe të ushtrimit të së drejtës së votës në asambletë e aksioneve.

dh) Në qoftë se është e nevojshme, klauzolat e statutit që kufizojnë shitjen e lirë të aksioneve.

e) Dispozitat përkatëse për shpërndarjen e fitimeve, krijimi i rezervave dhe shpërndarjen e shumës që mbetet pas likuidimit të shoqërisë.

ë) Në qoftë se është e nevojshme, shumën e obligacioneve të konvertueshme në aksione, të emetuara më parë, afatet e ushtrimit të mundësisë që u është dhënë prurësve ose shënimin që konvertimi mund të bëhet në çdo kohë, si dhe bazat e konvertimit.

f) Shumën paamortizuar të obligacioneve të tjera që janë emetuar më parë dhe garancitë, me të cilat ato janë të shoqëruara.

g) Shumën e huave të garantuar nga shoqëria dhe në qoftë se është e nevojshme, pjesën e garantuar të këtyre huave, gjatë procesit të emetimit.

Njoftimi përmban firmën e vulën e shoqërisë.

Neni 55

Bilanci që duhet t'i bashkëngjitet njoftimit

Një kopje e bilancit të fundit, e legalizuar sipas rregullave nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë, publikohet në aneks të njoftimit të përmendur në nenin e mësipërm. Në qoftë se bilanci i fundit është i publikuar tashmë në një gazetë të autorizuar për publikimin e njoftimeve ligjore, kopja e këtij bilanci mund të zëvendësohet me një shënim ku jepet referenca e publikimit të mëparshëm. Në qoftë se asnjë bilanc nuk është hartuar ende, në shënim bëhet fjalë për këtë gjë.

Neni 56
Prospektet dhe qarkoret

Prospektet për qëllime reklame dhe qarkoret që informojnë publikun mbi emetimin e aksioneve, përmbajnë të njëjtat njoftime si ato të parashikuara në nenin 54, si dhe shënimin që ai njoftim është publikuar në një gazetë zyrtare të autorizuar për publikimin e njoftimeve ligjore, duke dhënë referencën për emrin e gazetës dhe numrin e saj ku është publikuar njoftimi.

Afishet dhe njoftimet në gazeta riformulojnë të njëjtat shprehje ose, të paktën, një pjesë të këtyre shprehjeve, duke dhënë referencat për njoftimin dhe emrin e numrin e gazetës ku është publikuar njoftimi.

Neni 57
Buletini i nënshkrimeve

Buletini i nënshkrimeve të parashikuara në nenin 159 të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" është i datuar dhe i firmosur nga nënshkruesi ose mandatmbajtësi, i cili shkruan me shkronja numrin e letrave me vlerë të nënshkruara. Atij i jepet një kopje e buletinit.

Buletini i nënshkrimeve përmban emërtimin e shoqërisë, shumën e kapitalit themeltar, adresën e selisë së shoqërisë, numrin e regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar, si dhe:

a) Shumën dhe modalitetet e zmadhimit të kapitalit.

b) Në qoftë së është e nevojshme, shumën për t'u nënshkruar të aksioneve për kontributet në para dhe shumën e shlyer për kontributet nhjë natyrë.

c) Emrin dhe adresën e noterit ose emërtimin dhe selinë e bankës ku do të depizitohen fondet e ardhura nga nënshkrimi.

ç) Emrin, mbiemrin dhe adresën e banimit të nënshkruesit, si dhe numrin e letrave me vlerë të nënshkruara prej tij.

d) Njoftimin që nënshkruesit i është dhënë një kopje e buletinit të nënshkrimeve.

BASHKIMI DHE NDARJA

Neni 58
Projekti i bashkimit ose i ndarjes

Projekti i bashkimit ose i ndarjes formulohet nga drejtoria, administratori ose administratorët e secilës prej shoqërive që marrin pjesë në operacionin e bashkimit ose të ndarjes së projektuar.

Ai duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

a) Formën, emërtimin dhe selinë e gjithë shoqërive pjesëmarrëse.

b) Motivet, qëllimet dhe kushtet e bashkimit ose të ndarjes.

c) Caktimin dhe vlerësimin e aktivit dhe të pasivit që është parashikuar t'u kalojë shoqërive përthithëse ose të reja.

ç) Mënyrat e dorëzimit të pjesëve të kapitalit themeltar ose aksioneve dhe datën pas së cilës këto pjesë ose aksione japin të drejtë për pjesëmarrje në fitime, si dhe çdo modalitet i veçantë që lidhet me këtë të drejtë. Gjithashtu projekti duhet të përmbajë datën, pas së cilës operacionet e shoqërisë së përthithur ose të ndarë do të konsiderohen, në aspektin e kontabilitetit, si të kryera nga shoqëria ose shoqëritë që përfitojnë kontributet.

d) Datat, në të cilat janë hartuar llogaritë e shoqërive të interesuara, që përdoren për të formuluar kushtet e operacionit.

dh) Raportin e këmbimit të të drejtave në shoqëri dhe, në qoftë se është e nevojshme, shumën që duhet paguar për të kompensuar pabarazinë e këtyre të drejtave të këmbyera

e) Shumën e parashikuar të primit të bashkimit ose ndarjes.

ë) Të drejtat e dhëna ortakëve që kanë të drejta të veçanta dhe prurësve të letrave me vlerë të ndryshme nga aksionet, si dhe, në qoftë se është e nevojshme, të gjitha avantazhet e veçanta.

Neni 59

Shpallja e projektit të bashkimit ose të ndarjes

Projekti i bashkimit ose i ndarjes publikohet në formën e një shpalljeje në një gazetë të autorizuar për publikimin e njoftimeve ligjore, nga secila prej shoqërive që marrin pjesë në operacion.

Kjo shpallje përmban të dhënat e mëposhtme:

a) Emërtimin e shoqërisë, adresën e selisë, shumën e kapitalit dhe numrat e regjistrimit në regjistrin tregtar të secilës prej shoqërive që marrin pjesë në operacion.

b) Emërtimin e shoqërisë, adresën e selisë dhe shumën e kapitalit të shoqërive të reja që do të dalin nga operacioni ose shumën e zmadhimit të kapitalit të shoqërive ekzistuese.

c) Vlerësimin e aktivit dhe të paisivit të cilët janë parashikuar t'u kalojnë shoqërive pëthithëse ose të reja.

ç) Raportin e këmbimit të të drejtave në shoqëri.

d) Shumën e parashikuar të primit të bashkimit ose të ndarjes.

dh) Datën e projektit, si dhe datën e vendin e depozitimeve të parashikuara në nenin 248 të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".

Depozitimi në regjistrin tregtar, të parashikuar në nenin 248 paragrafi 2 të ligjit për shoqëritë tregtare dhe publikimi i parashikuar në pikat e përmendura më lart, duhet të bëhen të paktën një muaj përpara datës së mbledhjes së parë të Asamblesë, të thirrur për të marrë vendim për operacionin.

Neni 60

Deklaratë në përputhje me rregullat

Deklarata e parashikuar në nenin 248, paragrafi 3, të ligjit "Për shoqëritë tregtare", depozitohet me kërkesën për regjistrimin e ndryshimeve në regjistrin tregtar.

Ajo duhet të firmoset nga të paktën një anëtar i drejtorisë ose administrator i secilës prej shoqërive pjesëmarrëse, që kanë një mandat për këtë qëllim.

Një kopje depozitohet në aneksin e regjistrit tregtar për çdo shoqëri pjesëmarrëse që përbën objekt të një regjistrimi për ndryshime.

LIKUIDIMI

Neni 61

Emërimi i likuiduesve

Emërimi i likuiduesve duhet të regjistrohet në regjistrin tregtar. Akti i emërimit dhe shënimi i adresave të likuiduesve depozitohet në aneksin e regjistrit. Regjistrimi dhe adresat e likuiduesve publikohen sipas dispozitave të kreut I të këtij ligji.

Neni 62

Shpallja e mbylljes së likuidimit

Shpallja e mbylljes së likuidimit, e firmosur nga likuiduesi dhe nën kujdesin e tij, publikohet në një gazetë të autorizuar për publikimin e njoftimeve ligjore.

Në shpallje jepen emërtimi i shoqërisë, shuma e kapitalit themeltar, adresa e selisë së shoqërisë, numri i regjistrimit në regjistrin tregtar, si dhe:

a) Emrat, mbiemrat dhe adresat e banimit të likuiduesve.

b) Data dhe vendi i mbledhjes së Asamblesë për mbylljen, në qoftë se llogaritë e likuiduesve janë miratuar prej saj ose, në rast të kundërt, data e vendimit të gjyqit të parashikuar nga neni 271 i ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", si dhe gjykata që e ka marrë këtë vendim.

c) Referenca e regjistrit tregtar ku janë depozituar llogaritë e likuiduesve.

DISPOZITA TË TJERA

Neni 63

Regjistrimi i personave fizikë që janë regjistruar më parë si persona juridikë

Personat fizikë, që janë regjistruar më parë si persona juridikë përpara datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të konsiderohen sikur janë të regjistruar si tregtarë, në bazë të nenit 18 të ligjit nr.7632, datë 4.11.1992 "Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të kodit tregtar", me kusht që jo më vonë se 6 muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji të sjellin në gjykatën e caktuar për mbajtjen e regjistrit tregtar dokumentin që provon regjistrimin e tyre dhe të dhënat e kërkuara nga ky ligj për regjistrin tregtar.

Neni 64

Regjistrimi i shoqërive tregtare të regjistruara më parë

Shoqëritë tregtare, të regjistruara para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që formalitetet e regjistrimit dhe kushtet materiale nuk i kanë në përputhje me këtë ligj, janë të detyruara të regjistrohen jo më vonë se 6 muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji duke respektuar kërkesat e tij. Në qoftë se deri në këtë datë shoqëritë e sipërpërmendura nuk e kanë paraqitur kërkesën për riregjistrim dhe të gjitha dokumentet e kërkuara nga legjislacioni në fuqi, ato do të quhen të prishura automatikisht që nga kjo datë, por mund të kërkojnë në rrugë gjyqësore një shtyrje afati prej tre muajsh për të përmbushur detyrimin e mësipërm. Gjatë riregjistrimit të tyre shoqëritë trashëgojnë gjithë të drejtat e përfituara me rrugë ligjore para aktit të riregjistrimit.

Neni 65

Për një ndryshim në ligjin nr.7632, datë 4.11.1992

Në ligjin nr.7632, datë 4.11.1992 "Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të kodit tregtar", në nenin 13 fjalët "...me vendim të Këshillit të Ministrave..." zëvendësohen me fjalët: "...me ligj të veçantë".

Neni 66

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.455, datë 10.2.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.

ANEKSI I

Regjistri tregtar, Tiranë Faqe..... Numri i skedës së regjistrit.....

Numri rendor i regjistrimit	a) Emërtimi tregtar b) Vendi i sipërmarrjes ose selisë c) Objekti i shoqërisë d) Kapitali themeltar	Titullari i sipërmarrjes Administratorët Drejtoria rimit Likuiduesit	Regjistrime të tjera	a) Data e regjistrimit, firma e sekretarit të gjyqit b) Shënime
1	2	3	4	5

Vërejtje: Pjesët e nënvizuara ose me kryq të skedës së regjistrit janë prishur (janë çregjistruar) në përputhje me shënimet e ndryshimeve ose të prishjeve.